



www.legjislacioni.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 18

Tiranë – E hënë, 6 qershor 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Njoftim i ministrit të Financave Për vend të lirë pune.....	3
nr. 6180/6, datë 2.6.2016	



NJOFTIM

Nr. 6180/6, datë 2.6.2016

PËR VEND TË LIRË PUNE

Ministri i Financave, në zbatim të parashikimeve të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizimit”, të ndryshuar, dhe vendimit nr. 173, datë 7.3.2003 të Këshillit të Ministrave, “Për emërimin, lirin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve, në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose ministrit”, shpall hapjen e procedurave të përzgjedhjes së kandidatëve për Drejtorin e Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

Kandidatët duhet të plotësojnë këto **kritere të përgjithshme**:

1. Të jenë shtetas shqiptarë;
2. Të kenë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi;
4. Të mos jetë marrë ndaj tyre masa disiplinore të largimit nga shërbimi civil për shkak të një shkeljeje të rëndë disiplinore;
5. Të jenë në kushte shëndetësore të mira për të kryer detyrat përkatëse;
6. Arsimimi: master shkencor në shkenca juridike dhe/ose ekonomike;
7. Kandidatët duhet të ketë mbaruar njërin nga fakultetet me notë mesatare mbi 9.

Kandidatët duhet të plotësojnë këto **kritere të veçanta**:

1. Të ketë eksperiencë në fushën juridike/ekonomike;
2. Të ketë eksperiencë drejtimi, të paktën 5 (pesë) vite;
3. Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze dhe italiane, të mbrojtura.

Të gjithë kandidatët e interesuar duhet të paraqesin:

1. Kërkesë drejtuar ministrit të Financave;
2. Kopje të kartës së identitetit dhe certifikatës së gjendjes familjare;
3. *Curriculum Vitae*;
4. Kopje të noterizuar të diplomës universitare;
5. Listë notash të noterizuar;
6. Vërtetim të gjendjes gjyqësore;
7. Raport mjekoligjor;
8. Dëshmi të kualifikimeve dhe të mbrojtjes së gjuhës së huaj.

Kandidaturat e propozuara dhe dokumentacioni që vërteton përmbushjen e kritereve të përgjithshme dhe të posaçme të paraqitet brenda datës **22.6.2016, në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Financave**, në adresën: bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3, Tiranë.

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

Tiranë, 2016